

**ANALIZA**

Puna e IVMT-së gjatë vitit 2017, e përqendruar në lirim të hapësirave publike



FAQE 6

**INVESTIMI**

Në Paskuqan 2, Fushë, rrugë tërësisht e re, "Asim Zeneli", financim i buxhetit të Bashkisë



FAQE 3

**SOCIALE**

Qeveria u ka refuzuar ndihmën ekonomike qindra familjeve të varfra në Paskuqan



FAQE 7

**EMERGJENCAT**

Drejtoria e Shërbimeve Publike në kohë rekord përgatiti të gjitha dosjet për familjet e përmbytura



FAQE 7



# Gazetë e Bashkisë Kamëz

# KAMZA

E përdyjavshme  
Nr. 211 shkurt 2018  
Çmimi 20 lekë  
drmediakamez@gmail.com  
www.kamza.gov.al

## Intervista për gazetën "Telegraf"

# KRYEBASHKIAKU XHELAL MZIU: SI PO E DISKRIMINON QEVERIA KAMZËN

FAQE 4-5

**Analiza e Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike: Në 2017-ën vijoi diskriminimi i qeverisë ndaj Kamzës**

Faqe 7

**Kanalizimet në rrugën "Tomorri", në lagjen 3 Bathore, investimi i radhës i Bashkisë Kamëz**

Faqe 2

**Drejtorja e Menaxhimit të Tokës, Përmirësimi në Mjedis, e gatshme për shërbime ndaj qytetarëve**

Faqe 6

**Bashkia Kamëz do të realizojë në Laknas një tjetër investim, ndërtimin e trotuareve të rruga "Lura", 1480 metra e gjatë**

Faqe 2



**Ndërtimi i pedonales së qytetit, investim i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz për një infrastrukturë shërbyese për qytetarët e saj**

FAQE 2



**NË BRENDESI**

Sipërmarrja e suksesshme, "I sigurt drejt së ardhmes" - Intervistë me presidentin e kompanisë "Pirraçi-UG"

FAQE 8

Viti 2018, Bashkia Kamëz vijon investimet me ndërtimin e trotuareve në rrugën "7 Marsi" në lagjen Bathore 7

FAQE 3

Bashkëpunimi i Policisë Bashkiake me strukturat e tjera të Bashkisë, frytdhënës në përmbushjen e detyrave funksionale

FAQE 6

Ndërtimi i rrugës "Ali Këlcyra" në Paskuqan 2 Vresht, 1 km e gjatë, investim me rëndësi për vitin 2018

FAQE 2

Drejtorja e Burimeve Njerëzore, rol kryesor në institucionin e Bashkisë për të siguruar një shërbim cilësor për qytetarët

FAQE 7



## Ndërtimi i pedonales së qytetit, investim i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz, një infrastrukturë shërbyese për qytetarët e saj

Pedonalja e qytetit është një investim i rëndësishëm i Bashkisë Kamëz dhe një infrastrukturë shërbyese për qytetarët e saj. Investimi përfshin segmentin përgjatë Bulevardit Blu në të dyja anët e tij, me gjerësi 5 m dhe 8 m. Ka një shtrirje nga qendra e qytetit drejt kryqëzimit me rrugën "Londër". Realizimi i këtij investimi është një vepër që ka një impakt të ndjeshëm për të gjithë qytetarët e Kamëzës, jo vetëm kaq, por edhe të gjithë atyre që vërtet gjatë këtyre viteve kanë qenë të interesuar për jetën e këtij qyteti. Investimi ka të gjithë parametrat dhe standardet e duhura për një qytet me vitalitet të pakrahasueshëm jetësor.

Panorama e qendrës së qytetit do të jetë ndryshe duke krijuar një pamje të vërtetë të një qyteti evropian së bashku me qendrën e tij.

Përveç lehtësimit të lëvizjes për qytetarët, pedonalja



do të ofrojë edhe hapësira të tjera në dispozicion të tyre atyre. Ajo sjell përpara qytetarëve vizionin e Bashkisë jo vetëm për të ndryshuar pamjen, por sjell ndryshimin e duhur në infrastrukturë, nëpërmjet një projekti me të



gjithë parametrat e nevojshëm dhe bashkëkohorë, ku përfshihen shtresat me pllaka dekorative, stola, ndriçim, gjelbërim me pemë dhe lule, kosha mbeturinash etj.

### Vijojnë investimet e Bashkisë me ndërtimin e KUN-së në rrugën "Kujtesa" në Valias



Së shpejti do të nisin punimet për ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën "Kujtesa", e cila ndodhet në Valias. Ky investim do të realizohet tërësisht me fondet e parashikuara në buxhetin e Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Aktualisht gjatë kësaj rruge është një kanal me gjerësi prej 2 deri në 3 ml dhe me gjatësi 820 ml. Kjo KUN në rrugën "Kujtesa" ka një rëndësi të madhe sociale e mjedisore, pasi kanali në këtë zonë shtrihet pranë banesave. Duke qenë një situatë e tillë, kjo mund të jetë shkak për ndotjen e mjedisit. Pas realizimit të këtij investimi situata do të ndryshojë tërësisht, pasi rrjeti i KUN-së, i cili do të ketë parametrat e duhur bashkëkohorë, do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve. Ky investim, ku do të përdoren tuba me përmasa Ø 600 mm gjatë gjithë gjatësisë, financohet nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz.

### Kanalizimet në rrugën "Tomorri", në lagjen 3 Bathore, investimi i radhës i Bashkisë Kamëz




Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Tomorri", në lagjen 3 Bathore, është investimi i radhës i Bashkisë Kamëz për vitin 2018.

Në segmentin me gjatësi 285 metra linearë do të përdoren tuba me përmasa Ø 315. Ky projekt do të financohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz dhe është një nga investimet e parashikuara në buxhetin e këtij viti. Siç dihet tashmë, nga qeveria nuk është financuar asnjë nga 140 projektet me të cilët Bashkia ka aplikuar vit pas viti.

Megjithatë, kjo njësi vendore, falë mirëmenaxhimit të të ardhurave dhe partneritetit me organizma të huaj dhe vendas, ka realizuar dhjetëra investime në infrastrukturë, duke iu përgjigjur kështu me punë indiferencës dhe diskriminimit të Kryeministrit dhe qeverisë.

### Ndërtimi i rrugës "Ali Këlcyra" në Paskuqan 2 Vresht, 1 km e gjatë, investim me rëndësi për vitin 2018

Ndërtimi i rrugës "Ali Këlcyra" në Paskuqan 2 Vresht, 1 km e gjatë, është një nga investimet e rëndësishme të Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Përveç gjatësisë së saj, që shkon më shumë sesa 1 km dhe me gjerësi 9 metra, realizimi i këtij projekti sjell një impakt të jashtëzakonshëm social, si për



banorët e zonës, ashtu edhe për ata që zgjedhin të kalojnë në këtë segment rrugor. Bashkia Kamëz do të ndërhyjë me anë të këtij investimi për të krijuar kushte më të mira jetese për qytetarët e zonës, të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre për ndërtimin e një infrastrukture bashkëkohore.

Kryebashkiaku Xhelal Mziu është shprehur se synimi i Bashkisë është pikërisht që të krijojë një infrastrukturë të standardeve ndërkombëtare bashkëkohore. Qytetarët e Kamëzës dhe të Paskuqanit, por jo vetëm ata, janë dëshmitarë të dhjetëra investimeve të Bashkisë, të cilat po e përmirësojnë dita-ditës infrastrukturën e qytetit. Dhe kjo, në një kohë kur nga qeveria e majtë, për pesë vjet me radhë nuk është dhënë asnjë qindarkë për të financuar investime që u përkasin qytetarëve me bindje të djathta, të majta etj.

ujësjellësi, kanalizimet, rikonstrukcioni i kopshteve dhe i shkollave etj. Edhe ky projekt do të realizohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë, duke qenë se nga ana e qeverisë vijon mosfinancimi i investimeve në fusha jetike për qytetarët e Kamëzës, të cilat janë edhe qytetarë të Shqipërisë.

### Bashkia Kamëz do të realizojë në Laknas një tjetër investim, ndërtimin e trotuareve të rruga "Lura", 1480 metra e gjatë



Bashkia Kamëz do të realizojë në Laknas një tjetër investim. Bëhet fjalë për ndërtimin e trotuareve të rruga "Lura". Në planet e investimeve të Bashkisë Kamëz për vitin 2018 është pikërisht edhe ndërtimi i trotuareve të kësaj rruge.

Gjatësia e segmentit rrugor ku do të ndërhyhet me këtë investim është 1480 metra linearë. Rruga "Lura" ka një rëndësi të madhe, pasi bën lidhjen e dy rrugëve kryesore në këtë zonë, rruga "Lunxhëri" dhe rruga "Koka Kola", duke u shërbyer kështu mijëra qytetarëve.

Bashkia mbetet e angazhuar për të ndërtuar një infrastrukturë me standarde bashkëkohore dhe vlerëson çdo element të saj, duke filluar që nga rrugët, trotuaret,



## Në Paskuqan 2, Fushë, rrugë tërësisht e re, "Asim Zeneli", financim i buxhetit të Bashkisë Kamëz

Shkurt 2018  
GAZETA KAMZA

3



Në Paskuqan 2, Fushë, Bashkia Kamëz do të ndërtojë këtë vit rrugë tërësisht të re "Asim Zeneli", e cila do të ketë gjatësi 392 metra linearë dhe gjerësi 9 ml. Bashkia do të ndërhyjë në këtë segment, duke bërë kuotimin e tubave. Kështu, do të hiqen ata ekzistues dhe do të vendosen tuba me përmasa Ø 1500 dhe 2000, pastaj do të vijojë puna me ndërtimin e rrugës. Punimet përfshijnë disa procese, që nga prishja e avllive për të liruar hapësirat e nevojshme për investimin, gërmime me ekskavator, mbushje me çakull dhe shtresat përkatëse të asfaltit etj. Gjithashtu, edhe parametrat e tubave dhe pushtave do të jenë bashkëkohorë, me qëllim garantimin e cilësisë së investimit. Si çdo projekt tjetër në këto pesë vite, edhe ndërtimi i rrugës "Asim Zeneli" do të financohet nga buxheti i Bashkisë, duke qenë se qeveria e majtë nuk akordon asnjë qindarkë për investime në infrastrukturën e qytetit të Kamzës.



### Ndërtimi i rrugës "Bytyç" në lagjen Bathore 1

Rruga "Bytyç" në lagjen Bathore 1, me gjatësi rreth 200 metra linearë, do të jetë një tjetër investim i Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Ndërtimi i këtij segmenti rrugor është një prej dhjetëra projekteve të parashikuara për t'u realizuar gjatë këtij viti, i cili do të financohet tërësisht nga të ardhurat e vetë Bashkisë. Ashtu si vitet e tjera, edhe buxheti i vitit 2018 ka ruajtur traditën që pjesa më e madhe e tij të shkojë për investime publike, si për ndërtimin e rrugëve, të kanalizimeve, për rikonstrukcionin e kopshteve dhe shkollave etj.



Që nga viti 2007 e deri në vitin 2018, buxheti ka ardhur duke u rritur, si dhe është miratuar brenda afateve ligjore, madje në kohë rekord. Ka qenë kjo ecuri e Bashkisë që ka bërë të mundur që të shtohen investimet në dobi të qytetarëve, edhe në kushtet absurde, kur nga qeveria e majtë, gjithë këto vite nuk u akordua asnjë qindarkë për projektet jetike të Kamzës.

### Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Idriz Seferi" në lagjen Bathore 5



Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Idriz Seferi" në lagjen Bathore 5, me gjatësi 311 ml, është një investim tjetër i Bashkisë Kamëz për vitin 2018. Në këtë segment rrugor do të përdoren tuba me përmasa Ø 400. Duhet thënë se në Bathore, në Kamëz dhe Paskuqan do të ndërhyhet me dhjetëra investime për sa i përket infrastrukturës rrugore, të kanalizimeve, gjithashtu do të ketë ndërhyrje edhe në riparimin e objekteve arsimore. Projekti për ndërtimin e kanalizimeve në rrugën "Idriz Seferi" në lagjen Bathore 5 bën pjesë në investimet e parashikuara në buxhetin e Bashkisë për vitin 2018. Realizimi i këtij investimi do të sjellë ndikim pozitiv të jashtëzakonshëm social, për shkak se do të përmirësojë kushtet e jetesës për banorët e zonës. Ky është edhe pikësynimi i Bashkisë, që nëpërmes politikave zhvillimore të saj të bëjë të mundur përmirësimin e infrastrukturës urbane në qytetin e Kamzës. Dhe kjo, mbështetur vetëm në të ardhurat e vetë Bashkisë. Kështu, edhe këtë vit, mbi 60% e vlerës së buxhetit do të shkojë për investime publike.

### Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Orikumi" në Laknas



Projektet e Bashkisë Kamëz për vitin 2018 vijojnë me ndërtimin e kanalizimeve në rrugën "Orikumi" në Laknas. Segmenti ku do të ndërhyhet me këtë investim të nevojshëm për banorët e zonës, është i gjatë 300 metra linearë, ku do të përdoren tuba Ø 600. Investimi u shërben banorëve të zonës, si dhe bizneseve të ndryshme. Me realizimin e këtij projekti, shkohet edhe një hap më tej drejt objektivit për të arritur standarde bashkëkohore të infrastrukturës në të gjitha hapësirat e qytetit, qendër dhe jo qendër. Investimi do të realizohet me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2018. Me përfundimin e tij do të zgjidhet problemi i kanalizimeve në këtë zonë. Bashkia Kamëz ka të gatshme me dhjetëra projekte, të cilat kanë të bëjnë me nevojat parësore të qytetarëve, siç është ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, ndërtimi i shkollave dhe i kopshteve, i qendrave shëndetësore etj. Disa prej këtyre janë parashikuar të realizohen me të ardhurat e vetë Bashkisë, nëpërmjet realizimit të buxhetit të miratuar për vitin 2018. Ndërkohë, nga qeveria nuk është financuar asnjë prej më shumë se 137 projekteve, me të cilat ka aplikuar Bashkia gjatë këtyre viteve.

### Ndërtimi i rrugës "Abaz Ermenji" 540 metra e gjatë



Ndërtimi i rrugës "Abaz Ermenji", 540 metra e gjatë, është investimi i radhës i Bashkisë Kamëz në Paskuqan 2 Vresht. Kjo rrugë me një gjatësi të konsiderueshme, u vjen në ndihmë mijëra qytetarëve të kësaj zone, të cilët kanë kërkesa të shumta për investime. Këtyre kërkesave Bashkia dhe kryebashkiaku Xhelal Mziu u janë përgjigjur me dhjetëra projekte në rrugë dhe kanalizime, duke bërë realitet kështu edhe premtimin e tij për urbanizimin e Paskuqanit. Puna dhe investimet e deritanishme janë financuar tërësisht nga buxheti i Bashkisë i planifikuar për vitin 2018; në të kundërt qeveria e majtë dhe Kryeministri aktual e kanë diskriminuar vazhdimisht Kamzën dhe banorët e saj, duke mos financuar asnjë projekt jetik për ta.

### Viti 2018, Bashkia Kamëz vijon investimet me ndërtimin e trotuareve në rrugën "7 Marsi" në lagjen Bathore 7



Në planet e investimeve të Bashkisë Kamëz për vitin 2018 është edhe ndërtimi i trotuareve në rrugën "7 Marsi" në lagjen Bathore 7. Gjatësia e rrugës ku do të ndërhyhet me këtë investim është 630 metra linearë. Rruga "7 Marsi" ka një vlerë të madhe, pasi bën lidhjen e dy rrugëve kryesore në qytetin e Kamzës, rruga "Teuta" dhe rruga "Demokracia", duke u shërbyer kështu mijëra qytetarëve të lagjeve të Kamzës dhe Bathores.

Edhe ky projekt do të realizohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë, e cila është e angazhuar për të ndërtuar një infrastrukturë me standarde bashkëkohore dhe vlerëson çdo element të saj, duke filluar që nga rrugët, trotuaret, ujësjellësi, kanalizimet, rikonstrukcionin e kopshteve dhe i shkollave etj.



# Kryebashkiaku Xhelal Mziu: Si po e diskriminon qeveria Kamzën

## Kryetari i Bashkisë Kamëz: 65% e buxhetit 2018 do të shkojë për investime

Prej vitit 2007, janë shtruar me qindra e qindra kilometra rrugë dhe KUN (veçojmë rrugën e Babrrusë 7 km si dhe rivitalizimin e qendrës së saj), miratuar planin urbanistik, emërtuar mbi 505 rrugë dhe ka nisur puna për sheshin e ri të qytetit dhe pedonalen e Kamzës. Mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellësi dhe furnizim me ujë. U ndërtua Pallati i Kulturës, palestra e Bathores, stadiumi i qytetit si dhe 18 objekte shkollore, u 4-fishuar numri i bizneseve dhe ardhurat e Bashkisë janë mbi 10-fishuar krahasuar me vite më parë.

Prej vitit 2013 jemi diskriminuar nga qeveria. Mbi 137 projekte që fllenë në sirtarët e qeverisë dhe asnjë përgjigje nuk kemi marrë. Nuk na kalojnë kompetencat, kanë hequr mijëra familjeve nga skema e ndihmës ekonomike, nuk na akordojnë numrin e duhur bursave... etj.

Zoti Mziu, në fillim dhjetori të vitit të kaluar keni kaluar buxhetin për vitin 2018 të Bashkisë Kamëz. Veç faktit që pati votë unanime si rrallë ndonjëherë jo vetëm në Bashkinë tuaj por dhe të tjerat, cilat janë rrisitë e këtij buxheti?

Është e vërtet që më 11 dhjetor, Bashkia Kamëz kaloi në Këshillin Bashkiak, buxhetin për vitin 2018. Para këshilltarëve si çdo vit unë personalisht kam mbrojtur dhe prezantuar me detaje buxhetin, duke bërë transparencën maksimale se për çfarë do të përdoren të ardhurat e Bashkisë, grantet e pakushtëzuara si dhe çdo e ardhur tjetër vendore, grand apo gjithçfarë. Pas prezantimit, këshilltarët e të gjitha forcave politike përfaqësuese në Këshillin Bashkiak, të bindur në transparencën e Bashkisë, por tashmë dhe punën e saj në terren ku Kamza dhe Paskuqanin janë kthyer në kantier ndërtimi, votuan unanimit. Ky është një prej buxheteve më të mëdha ndër vite edhe pse Bashkia Kamëz nga vitit në vit buxhetin e ka pas më të madh në vlerë, ku pjesa e luanit ka shkuar për investime të cilat kthehen në të mirë të komunitetit.



Bashkia Kamëz, si një zonë informale ka pasur imediate thaujse çdo vit përmirësimin e infrastrukturës. Ne kemi bërë maksimumin që fondet t'i përdorim për këtë qëllim dhe deri më tani kemi bërë një punë të madhe. Të paktën prej vitit 2007, kur unë jam zgjedhur kryetar i Bashkisë Kamëz, janë më qindra e qindra kilometra rrugë të asfaltuar (shtruar edhe KUN). Buxheti i vitit 2018 është diskutuar me grupet e interesit, por dhe qytetarët ku kemi mundur të evidentojmë nevojat që ata kanë, e më pas është përgatitur dhe erdhëm deri tek dita e votimit, gjë që çoi dhe në bindjen absolute të këshilltarëve për ta votuar të gjithë.

Dua të theksoj se 65% e buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2018 do të shkojë për investime. Ne si Bashki, ndryshe nga homologet, punojmë me një staf të vogël por eficient dhe fondet nuk i çojmë për paga dhe sigurime shoqërore, por investime!

Një pjesë e konsiderueshme të buxhetit e zënë të ardhurat vendore dhe kjo ka ardhur falë një pune të mirë të bërë në terren, luftës ndaj informalitetit si dhe shtim të numrit të biznesit.

A parashikon ky buxhet mbështetje për kategoritë në nevojë, shtresat sociale apo familjeve me të cilat përballen me fatkeqësi natyrore?

Sigurisht që Bashkia Kamëz parashikon buxhet për këto kategori shoqërore. Edhe për vitin 2018, do të vazhdojë mbështetje për shtresat e qytetarëve në nevojë, sikurse

kemi bërë deri më tani. Mbështetje do të ketë edhe për nxënësit dhe studentët e mirë ku do të ju akordohet bursa sipas meritës. Bashkia Kamëz herë pas here ka akorduar ndihma për familjet me të ardhura të pakta, me ndihmë ekonomike, në kushte të vështira jetese, si dhe raste përmbytjesh. Ne brenda mundësish jemi munduar t'u gjendemi pranë qytetarëve.

Gjatë vitit 2017, ju kemi parë në terren në inspektim dhe inaugurim rrugësh thaujse çdo ditë, madje dhe në ditët e nxehta të verës, ku jo vetëm që nuk e keni ulur, por e keni ngritur tempin e punës. A realizoi investime Bashkia Kamëz këtë vit dhe cilat mund të na përmendni më kryesoret?

E theksova edhe më lart, prioritetimi si kryebashkiak dhe stafit tim ka qenë përmirësimi rrënjësor i infrastrukturës së Bashkisë Kamëz (tashmë kemi edhe Paskuqanin) dhe besojë në këtë drejtim ia kemi dal. Pa dashur të ndalem në investimet pa fund të bëra në Kamëz në dy mandatet e para 2007-2011 dhe 2011-2015 të cilat janë të shumta, gjatë këtij mandati projektet e Bashkisë të realizuara vetëm sa janë shtuar. Këtë vit, pra në vitin 2017, Bashkia Kamëz ka pasur në proces realizimi plot 60 projekte në infrastrukturë (rrugë+KUN), të cilat pjesa më e madhe e tyre janë realizuar dhe një pjesë janë drejt përfundimit. Këto projekte kanë ndikuar dukshëm dhe kanë dhënë impakt social në komunitet si dhe kanë ndihmuar në zhvillimin e biznesit në zonë. Investimet kanë qenë në rrugë dhe KUN. Dua të theksoj së prioritet ka qenë më shumë zona e Paskuqanit për faktin se nevojat kanë qenë më të mëdha atje. Përpos investimeve të tjera, në Paskuqan dua të përmend projektin e rrugës nga Ura e Universitetit Bujqësor në Babrru që ka përfunduar dhe do të shkojë deri tek kafa e Rremës një investim 100% me fondet e Bashkisë prej 7 km, tashmë më e gjerë, me trotuaire, gjelbërim dhe sinjalistikë, që i vjen në ndihmë jo vetëm 50 mijë banorëve të Paskuqanit por dhe qytetarëve të Tiranës dhe të tjerëve që zgjedhin të kalojnë në Tiranë përmes këtij aksi.

A ka projekte që keni në zbatim që nuk kanë përfunduar në 2017. Po Qendra e re dhe Pedonalja e Kamzës kur pritet të bëhet realitet?

E theksova edhe më lart, janë pak projekte që ende nuk kanë përfunduar në 2017 dhe janë në realizim e sipër dhe shpejt do të jenë të prekshme për banorët. Po punohet më ritme të shpejta që rrugët dhe KUN në proces të

përfundojnë sa më shpejt.

Ndër investimet e rëndësishme të këtij viti dua të përmend; rivitalizimin e qendrës së Babrrusë ku po shkojnë drejt mbarimit punimet, si dhe kanë nisur punimet për investimin madhor të Kamëz për ndërtimin e Qendrës së Re të qytetit si dhe Pedonale.

Zoti Mziu këtë vit Kamza pati përmbytje. Ju pamë që shoqëruat kryeministrin Rama. Çfarë i kërkuat dhe a mendoni se pas atij takimi të shkurtër do të shkrihen akujt me Bashkisë Kamëz dhe qeverisë?

Së pari dua të theksoj që Kamza sivjet ka pasur përmbytje më pak se herët e tjera kjo fal punës së mirë të bërë nga Bashkia në terren në pastrimin e kolektorëve. Sa i përket takimit më kryeministrin, bashkëpunimi im nuk ka munguar asnjëherë. Bashkëpunim nuk quhet vetëm takimi fizik e sidomos në atë rast emergjence, por dhe ai institucional. Unë si kryetar i Bashkisë Kamëz i kam dërguar me dhjetëra e dhjetëra shkresa kryeministrin,

# INTERVISTA PËR GAZETËN "TELEGRAF"

Shkurt 2018  
GAZETA KAMZA

5



qeverisë për bashkëpunim ku i kam kërkuar mbështetje financiare. Janë mbi 137 projekte që flenë në sirtarët e qeverisë dhe asnjë përgjigje nuk kemi marrë! A nuk është ky absurd, ku Bashkia e gjashtë më e madhe në vend nuk gjen mbështetje e ekzekutiv! Kalojnë kompetencat nuk shoqërohen me fondet përkatëse, por as dhe me asetet që drejtoritë që kanë pasur. Mund të marrim p.sh.: kalojnë zjarrfikëset, por jo stacioni i zjarrfikëseve në Kodër-Kamëz, një konvikti në territorin tone të i kalon Bashkisë së Tiranës, asnjë mjet nuk kalon nga bordi i kullimit dhe madje kur qeveria bleu 61 ekskavatorë për bashkitë të gjithëve u dha nga 1, Bashkisë së Tiranës 2, kurse Kamzës zero. Këto dhe të tjera moskalime kompetencash dhe mungesë bashkëpunimi janë një problem jo i vogël. Qeveria e ka detyrim të mbështesë bashkitë dhe ato nuk duhen parë më syrin politik. Unë nuk kam ngrirë asnjëherë në marrëdhënie institucionale me qeverinë, por shpresoj të shkrijë qeveria. Fakti që unë i kam kërkuar qeverisë financim të projekteve në rrugë zyrtare kam besuar se do gjeja mbështetje. Deri tani nuk ka ndodhur shpresoj që të reflektohet. Në atë takim të shkurtër veç dëmshpërblimit të familjeve të përmytura, Ramës i parashtrava dhe kërkesat emergjente siç janë; financimi i kolektorëve; Valias i Ri, Valias i Vjetër, i kolektorit Zall-Herr-Bathore-Frutikulturë, pajisja me ekskavator, gjë që i ishte mohuar më parë nga

Kamza përfaqëson 5% të numrit të popullsisë në shkallë vendi. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka një numër total të bursave për arsimin e lartë në shkallë vendi 1800 (një mijë e tetëqind). Të ndodhur përpara këtyre fakteve në ndarje matematikore i përkon që Bashkisë Kamëz t'i jepen 90 (nëntëdhjetë) bursa studimore. Aktualisht ajo ka marrë 6 herë më pak sesa fakti real që Bashkia Kamëz duhet të ishte përfituese. Edhe në kushtet e dhënies së 90 bursave studimore, përsëri do të kishim një vështirësi në ndarjen e tyre, pasi kërkesa për to është shumë herë më e lartë dhe e vlerësuar sipas kriterëve përfituese. Jo më tani që për studentët e Bashkisë Kamëz mbeten vetëm 15 bursa studimore dhe diskriminimi vjen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si një trajtim i vërtetë politik ku të dëmtuar nga ky vlerësim dalin studentët e qytetit të Kamzës. Ky diskriminim është vazhde e trajtimit të qytetarëve të Kamzës si qytetarë të dorës së dytë. Për të gjithë këto i jemi drejtuar me shkresa zyrtare dikasterit përgjegjës të qeverisë shqiptare. Edhe sa i përket trajtimit të familjeve me ndihmë ekonomike sërish Bashkia Kamëz me një popullsi me 150 mijë banorë diskriminohet. Vetëm këtë fillim viti Bashkisë Kamëz i janë hequr 782 familje nga skema e ndihmës ekonomike, të hequra padrejtësisht (diskriminim politik). Nga 2013 deri sot janë hequr mbi 5 mijë familje nga skema e ndihmës ekonomike!

biznesit gjë që ka çuar në rritjen e numrit të të punësuarve me mbi 10 mijë veta ku një ndihmë ka dhënë sektori fason. Të ardhurat e Bashkisë janë mbi 10-fishuar krahasuar me vite më parë. Kamza sot është një qytet i pastër me makineri pastrimi bashkëkohore dhe kontejnerë të standardeve evropiane. Mundësuam shtrirjen e linjës së telefonisë fikse dhe internetit në gjithë territorin e Kamzës, ndërtuam



rrugën Demokracia 7 km të gjatë nga Ura e Institutit në Babrru deri tek kafa e Rremës etj. Të tjera projekte janë në zbatim jo vetëm ndërtimin e qindra km rrugë dhe KUZ, por dhe qendra e qytetit të Kamzës bashkë me pedonalen, rehabilitimi i Qendrës së Babrrusë etj.

**Kamza ka spikat dhe në sport. Ekipi i futbollit nga debutues është kthyer në pretendent në superligë. A e ka mbështetur Bashkia sportin dhe kulturën?**  
Sporti dhe kultura kanë pasur gjithnjë mbështetjen e Bashkisë. Këtë vit jemi mirë në futboll, por Kamza ka qenë dhe më parë në Superligë. Veç futbollit kemi qenë dhe jemi mirë dhe në Basketboll si dhe sporte të tjera si Karate etj. Bashkia veç mbështetjes së ekipit ka punuar dhe po punon në përmirësimin dhe shtimin e infrastrukturës sportive ku mund të përmendim stadiumin, apo terreneve të tjera sportive si dhe palestra e Bathores për ekipin e Basketbollit.

**Një pyetje të fundit z. Mziu të cilën nuk mund të mos ta bënim. Bashkia Kamëz u rendit nga MF si Bashkia me performancën më të financiare. Si u ndjetë pas këtij vlerësimi?**  
Sigurisht që një vlerësim i tillë për ne është inkurajues në fushën e financave për të vazhduar dhe bërë më të mirë. Është një lajm i mirë për ne, aq më tepër kur vjen nga Ministria e Financave pjesë e kësaj qeverie e cila vetëm baltë ka hedhur herë pas here mbi punën tonë. Ky është rasti për të treguar që shifrat nuk të lënë të gabosh dhe shpifësh.

Botuar në gazetën "Telegraf", më 16 shkurt 2018



**Si paraqitet gjendja e furnizimit më ujë në Kamëz?**  
Ka një përmirësim rrënjësor të furnizimit më ujë në Kamëz. Tashmë ka mbaruar faza e parë e ujësjellësit ku zbatimi i këtij projekti mundësoi furnizimin me ujë të pijshëm të gati 70 për qind të qytetarëve të Kamzës, një financim KfW. U mundësua mbyllja e fazës së parë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve nga banka gjermane KfW, dhe së shpejti fillon implementimi i fazave të tjera. Aktualisht mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellësi dhe furnizim me ujë.



**A mund të na bëni një bilanc të punës suaj në 3 mandate në krye të Bashkisë?**  
Kamza ka pësuar ndryshime rrënjësore e ndoshta do duhen faqe të tëra gazeta për të numëruar arritjet, ose projektet e realizuara. Krahasuar me vitin 2007 kur u ula në karrigen e kryebashkiakut, realiteti është krejt ndryshe. Jemi ndër qytetet e para që miratuam planin urbanistik, qyteti i vetëm me sistem të plotë adresash ku kemi emërtuar mbi 505 rrugëve dhe Kamza është gati për implementimin e ZIP-KOD-it. Janë asfaltuar me qindra e qindra km rrugë, janë shtrirë me qindra rrjet të ujësjellës-kanalizimeve duke përmirësuar ndjeshëm furnizimin me ujë të pijshëm. U mundësua mbyllja e fazës së parë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve nga banka gjermane KfW, dhe së shpejti fillon implementimi i fazave të tjera. Sot mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellësi dhe furnizim me ujë. Kemi mundësuar dhe shtrirjen e rrjetit të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike 20 kv mbi 70% të popullsisë.

ana e qeverisë si dhe pajisja e Kamzës me një stacion zjarrfikëseje duke qenë se nuk e ka.

**A mendoni se do keni mbështetjen e qeverisë për faktin se e keni nisur Vitin e ri sërish me një ankesë ndaj Ministrisë së Arsimit sa i përket shpërndarjes së numrit të bursave apo ne janar Kamzës i janë hequr qindra familje nga skema e ndihmës ekonomike?**  
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në këtë fillim viti ka akorduar për studentët e Bashkisë Kamëz vetëm 15 (pesëmbëdhjetë) bursa të arsimit të lartë për vitin akademik 2017-2018. Referuar numrit real të popullsisë në Bashkinë Kamëz, regjistron 140.000 banorë, e thënë ndryshe,

Janë ndërtuar 18 objekte shkollore (shkolla dhe kopshte) me standarde evropiane. Bashkia ka ndërtuar Pallatin modern të Kulturës për të rinjtë dhe të gjithë qytetarët një nga më të mirët në vend. U ndërtua stadiumi i qytetit si dhe palestra moderne e basketbollit në Bathore. Kemi ngritur qendrën e shërbimeve ndaj qytetarëve, One Stop Shop, më e mira në Shqipëri, e vlerësuar nga ndërkombëtarët si praktika më e mirë e qeverisjes vendore. Është 4-fishuar numri i bizneseve fal taksave të ulëta dhe klimës së mirë që kemi krijuar, gjë që na ka mundësuar dhe punësimin e mijëra qytetarëve. Bashkia Kamëz ka pasur një paketë fiskale konkurruese dhe stimuluese për zhvillimin e

qeverisë për bashkëpunim ku i kam kërkuar mbështetje financiare. Janë mbi 137 projekte që flenë në sirtarët e qeverisë dhe asnjë përgjigje nuk kemi marrë! A nuk është ky absurd, ku Bashkia e gjashtë më e madhe në vend nuk gjen mbështetje e ekzekutiv! Kalojnë kompetencat nuk shoqërohen me fondet përkatëse, por as dhe me asetet që drejtoritë që kanë pasur. Mund të marrim p.sh.: kalojnë zjarrfikëset, por jo stacioni i zjarrfikëseve në Kodër-Kamëz, një konvikti në territorin tone të i kalon Bashkisë së Tiranës, asnjë mjet nuk kalon nga bordi i kullimit dhe madje kur qeveria bleu 61 ekskavatorë për bashkitë të gjithëve u dha nga 1, Bashkisë së Tiranës 2, kurse Kamzës zero. Këto dhe të tjera moskalime kompetencash dhe mungesë bashkëpunimi janë një problem jo i vogël. Qeveria e ka detyrim të mbështesë bashkitë dhe ato nuk duhen parë më syrin politik. Unë nuk kam ngrirë asnjëherë në marrëdhënie institucionale me qeverinë, por shpresoj të shkrijë qeveria. Fakti që unë i kam kërkuar qeverisë financim të projekteve në rrugë zyrtare kam besuar se do gjeja mbështetje. Deri tani nuk ka ndodhur shpresoj që të reflektohet. Në atë takim të shkurtër veç dëmshpërblimit të familjeve të përmytura, Ramës i parashtrava dhe kërkesat emergjente siç janë; financimi i kolektorëve; Valias i Ri, Valias i Vjetër, i kolektorit Zall-Herr-Bathore-Frutikulturë, pajisja me ekskavator, gjë që i ishte mohuar më parë nga

**Si paraqitet gjendja e furnizimit më ujë në Kamëz?**  
Ka një përmirësim rrënjësor të furnizimit më ujë në Kamëz. Tashmë ka mbaruar faza e parë e ujësjellësit ku zbatimi i këtij projekti mundësoi furnizimin me ujë të pijshëm të gati 70 për qind të qytetarëve të Kamzës, një financim KfW. U mundësua mbyllja e fazës së parë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve nga banka gjermane KfW, dhe së shpejti fillon implementimi i fazave të tjera. Aktualisht mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellësi dhe furnizim me ujë.

**A mund të na bëni një bilanc të punës suaj në 3 mandate në krye të Bashkisë?**  
Kamza ka pësuar ndryshime rrënjësore e ndoshta do duhen faqe të tëra gazeta për të numëruar arritjet, ose projektet e realizuara. Krahasuar me vitin 2007 kur u ula në karrigen e kryebashkiakut, realiteti është krejt ndryshe. Jemi ndër qytetet e para që miratuam planin urbanistik, qyteti i vetëm me sistem të plotë adresash ku kemi emërtuar mbi 505 rrugëve dhe Kamza është gati për implementimin e ZIP-KOD-it. Janë asfaltuar me qindra e qindra km rrugë, janë shtrirë me qindra rrjet të ujësjellës-kanalizimeve duke përmirësuar ndjeshëm furnizimin me ujë të pijshëm. U mundësua mbyllja e fazës së parë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve nga banka gjermane KfW, dhe së shpejti fillon implementimi i fazave të tjera. Sot mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellësi dhe furnizim me ujë. Kemi mundësuar dhe shtrirjen e rrjetit të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike 20 kv mbi 70% të popullsisë.

ana e qeverisë si dhe pajisja e Kamzës me një stacion zjarrfikëseje duke qenë se nuk e ka.

**A mendoni se do keni mbështetjen e qeverisë për faktin se e keni nisur Vitin e ri sërish me një ankesë ndaj Ministrisë së Arsimit sa i përket shpërndarjes së numrit të bursave apo ne janar Kamzës i janë hequr qindra familje nga skema e ndihmës ekonomike?**  
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në këtë fillim viti ka akorduar për studentët e Bashkisë Kamëz vetëm 15 (pesëmbëdhjetë) bursa të arsimit të lartë për vitin akademik 2017-2018. Referuar numrit real të popullsisë në Bashkinë Kamëz, regjistron 140.000 banorë, e thënë ndryshe,

Janë ndërtuar 18 objekte shkollore (shkolla dhe kopshte) me standarde evropiane. Bashkia ka ndërtuar Pallatin modern të Kulturës për të rinjtë dhe të gjithë qytetarët një nga më të mirët në vend. U ndërtua stadiumi i qytetit si dhe palestra moderne e basketbollit në Bathore. Kemi ngritur qendrën e shërbimeve ndaj qytetarëve, One Stop Shop, më e mira në Shqipëri, e vlerësuar nga ndërkombëtarët si praktika më e mirë e qeverisjes vendore. Është 4-fishuar numri i bizneseve fal taksave të ulëta dhe klimës së mirë që kemi krijuar, gjë që na ka mundësuar dhe punësimin e mijëra qytetarëve. Bashkia Kamëz ka pasur një paketë fiskale konkurruese dhe stimuluese për zhvillimin e



# Puna e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit gjatë vitit 2017, e përqendruar në lirimimin e hapësirave publike

Motoja e punës së Inspektoratit Vendor i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Kamëz ka qenë parandalimi i ndërtimeve të paligjshme brenda territorit të Bashkisë Kamëz, lirimi i hapësirave publike të zëna në mënyrë të paligjshme, zgjidhja e ankesave të ardhura nga komuniteti si dhe vënia në dispozicion të Drejtorisë së PKZHT-së dhe azhurnimet në terren në lagjet të Kamzës, Bathore, Frutikulturë, Valias si dhe në bulevardin “Demokracia” dhe Babrru-Qendër në zonën Paskuqan etj., në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për lirimimin e hapësirave publike në të gjitha investimet si dhe në argjaturën e lumit të Tiranës, lumit të Tërkuzës dhe lumit Lana në zonën e Laknasit. Gjatë analizës së punës për vitin 2017, u theksua se puna e IVMT-së ka qenë e përqendruar edhe në lirimimin e hapësirave publike në zbatimin e projekteve të rrugëve si dhe ndihmën për të filluar dhe vazhduar punën nga firmat pa problem si për shembull në rrugët e mëposhtme ku janë bërë njoftimet përkatëse për lirimimin e hapësirave në zbatimin e projekteve sipas parametrave bashkëkohore:

Gjatë vitit 2017 është punuar me intensitet të plotë në grupe pune me Drejtorinë e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Tokës dhe Përmirësimit në Mjedis për hapjen e hapësirave publike si dhe në zgjidhjen e konflikteve të ndryshme.

Kështu, është bërë e mundur hapja e hapësirave për realizimin e dhjetëra investimeve.

Hapje e hapësirave për ndërtimin e rrugëve

Rruga “Coca Cola”

Rruga “Liria” (vazhdim)



Rruga “Zgjimi”

Rruga “Arben Broci” + QTA + Vazhdim

Rruga “Abdi Bej Toptani

Rruga “Ymer Haxhi Prizreni”

Rruga “Ejll Dedja”

Rruga “Ismail Qemali”

Rruga “Australia”

Rruga “Butrinti”

Rruga “Pashtriku”

Rruga “Migjeni”

Rruga “Mësonjëtorja”

Rruga “Dardania”

Rruga “Rilindja”

Rruga “Elez Isufi”

Rruga “Burrel”

Rruga “Halim Xhelu”

Rruga Babrru – Kodër e Kuqe

Rruga “Milano”

Rruga “Aleksandria”

Rruga “Napoli”

Rruga “Peshkopia”

Bulevardi “Demokracia”

Rruga “Kingstoni”

Rruga “Gurre”

Rruga “Loro Boriçi”

Rruga “Faik Hoxhaj”

Hapje e hapësirave për KUN

KUN te rruga “Zgjimi”

KUN te rruga “Selenicë”

KUN te rruga “Shekspiri”

KUN te rruga “Viktor Hygo”

KUN te rruga “Fatmirësia”

KUN te rruga “Strasburgu”

KUN te rruga “Burimi”

KUN te rruga “Buenos Aires”

KUN te rruga “Montekarlo”

KUN te rruga “Australia”

KUN te rruga “Abdi Bej Toptani”

KUN te rruga “Harku i Triumfit”

KUN te rruga “Kujtesa”

KUN te rruga “Ajet Xhindoli”

KUN te rruga “Orikum”

KUN te rruga “Zgjimi”

KUN te rruga “Abdyl Ypi”

KUN te rruga “Ago Agai”

KUN te rruga “Xhovani Faust”

KUN te rruga “Abdyl Elmazi”

KUN te rruga “Kukës”

## Bashkëpunimi i Policisë Bashkiake me strukturat e tjera të Bashkisë, frytdhënës në përmbushjen e detyrave funksionale



Bashkëpunimi i Policisë Bashkiake me strukturat e tjera të Bashkisë gjatë vitit që shkoi ka rezultuar frytdhënës në përmbushjen e detyrave, funksioneve dhe objektivave të vëna. Puna e Policisë Bashkiake për vitin 2017 ka qenë rezultative në shumë drejtime dhe roli i saj, si forcë ekzekutive në ndihmë të ushtrimit të funksioneve të organeve dhe strukturave të Bashkisë, ka qenë i rëndësishëm. Në analizën e zhvilluar për punën gjatë vitit 2017, ndër të tjera u theksua se një faktor kyç në arritjen e rezultateve dhe përmbushjen e objektivave mbetet bashkëpunimi i kësaj strukture me drejtorinë dhe sektorin e ndryshëm të administratës së Bashkisë Kamëz. Kështu, bashkëpunimi me Drejtorinë e Taksave dhe e Tarifave Vendore ka vijuar me evidentimin e bizneseve në territorin e Bashkisë Kamëz si dhe në Njësinë Administrative Paskuqan. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Transportit është kryer kontrolli i mjeteve që janë licencuar nga ana e Bashkisë. Janë marrë edhe masa administrative me gjobë për mjete të palicencuara, të cilat kanë hyrë në linjat e Kamzës. Me Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë ekzekutuar disa vendime. Këto vendime janë marrë për mbylljen e disa bizneseve që nuk kanë shlyer detyrimet, si edhe për mjetet e transportit. Janë ngritur grupe pune me turne në zonën e Paskuqanit, te bulevardi “Demokracia”, për kontrollin e mjeteve të

tonazhit të rëndë, duke qenë eficientë në punën e saj. Është punuar për kontrollin e mjeteve të transportit të nxënësve, urbanët e transportit publik si dhe mjetet e rënda. Policia Bashkiake ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me Pallatin e Kulturës për mbarëvajtjen e veprimtarive kulturore. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Policia Bashkiake ka qenë e gatshme për zbatimin e urdhrave dhe të vendimeve të kësaj drejtorie për t'i ardhur në ndihmë në hapjen e hapësirave publike për azhurnimin e projekteve të rrugëve si dhe marrjen e masave për ecurinë e zbatimit të projektit nga subjektet ndërtuese. Edhe me Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake ka bashkëpunuar për zbatimin e urdhrave dhe të vendimeve nga institucioni për t'i ardhur në ndihmë në hapjen e hapësirave publike etj. Me Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve ka pasur bashkëpunim për zbatimin e urdhrave dhe të vendimeve të kësaj ndërmarrjeje për ndërprerjen e ujit për lidhjet e paligjshme si dhe për të gjitha subjektet apo personat që rezultojnë debitorë. Në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit është kryer kontrolli i territorit për moslejimin e prishjes së dekorit të qytetit si dhe penalizimin e të gjithë atyre që hedhin mbeturina në vende të palejuara nga kjo ndërmarrje. Detyrë tjetër ka qenë edhe zgjidhja e konflikteve të varrezat e qytetit, si dhe zgjidhja e konfliktit për vendgrumbullimin e mbeturinave. Duke pasur këtë bashkëpunim, ushtrimi i funksionit të Drejtorisë së Policisë Bashkiake Kamëz ka qenë mjaft i suksesshëm dhe i frytdhënës, në zbatimin e ligjit dhe detyrave që i janë ngarkuar.

## Drejtoria e Menaxhimit të Tokës, Përmirësimit në Mjedis, e gatshme për shërbime ndaj qytetarëve



Gjatë analizës për punën e vitit të kaluar të Drejtorisë së Menaxhimit të Tokës, Përmirësimit në Mjedis, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, u theksua fakti se kjo drejtori është angazhuar me të gjitha kapacitetet e mundshme në realizimin e detyrave të ngarkuara për vitin 2017. Ajo ka qenë e gatshme për shërbime ndaj qytetarëve, ndërkohë që ka vijuar me korrespondencën zyrtare me të gjitha institucionet; me vjeljen e të ardhurave nga toka bujqësore si dhe tarifa e shitjes; me hedhjen në sistem të të gjithë pronarëve të rinj; rakordimin e sipërfaqeve të shpërndara me ligjin 7501 dhe identifikimin i pronarëve të rinj sipas ligjit për shitblerjen e tokës; evidentimin e të gjitha pronave shtetërore brenda territorit të Bashkisë Kamëz dhe përgatitja e hartës sipas përkatësisë së pronësisë; mirëmenaxhimin e mjedisit dhe masat për përmirësimin e tij.

Qytetarët janë ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme me përgjigjet dhe relacionet shpjeguese që ka dërguar drejtorja të konfirmuara këto dhe nga kryetari i Bashkisë. Pavarësisht gatishmërisë së punës së Drejtorisë së Menaxhimit të Tokës, Përmirësimit në Mjedis, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave, mund të thuhet që për qytetarët e Kamzës vazhdon sorollatja në dyert e ZVRPP-së, e cila ka rezultuar padrejtësisht me penalizim, duke bllokuar veprimet për pronat që janë certifikuar vite

më parë. Investimi i bërë nga Bashkia për pastrimin e kanaleve kulluese solli shmangien e përmblytjeve në lagjen Lura në Laknas, përmirësoi situatën e përmblytjeve në Valias, Frutikulturë dhe në vazhdimësi përmirëson funksionimin e rrjetit kullues për vitet në vazhdim. Duke qenë funksione të deleguara ka munguar i gjithë dokumentacioni për pyjet/kullota, qoftë në anën dokumentare ashtu edhe për gjetje fizike në terren të sipërfaqeve. Puna në këtë drejtim ka qenë e mbushur plot me problematika të qëllimshme nga institucionet përgjegjëse dhe konkretisht Ministria e Mjedisit, Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, Agjencia e Zonave të Mbrojtura, Kryeministri etj., duke mos vënë në dispozicion asnjë dokumentacion, duke mos përfshirë asnjëherë Kamzën për t'u bërë pjesë e diskutimeve për procesin e transferimit të pyjeve/kullotave në pronësi të Bashkisë, me gjithë korrespondencën zyrtare të bërë nga ana e kësaj njësie vendore me të gjitha këto institucione.

Për sa i përket situatës mjedisore, ka pasur përmirësime të ndjeshme si rezultat i ndërtimit të infrastrukturës dhe hartimit të planeve afatmesme dhe afatgjata nga ana e Bashkisë Kamëz. Politikat mjedisore janë jetike dhe kanë të bëjnë me jetën e qytetarëve të tanishëm dhe për t'u lënë brezave të tjerë një mjedis me parametra optimalë dhe brenda potencialeve mbartës të tij. Vlerësime dhe rekomandime për këtë drejtori dha në fund të analizës sekretari i përgjithshëm, z. Qemal Çejku, për punën intensive dhe për prezantimin e analizës vjetore me detaje. Ndërkaq, u sugjerua që të ketë shkresa të detajuara drejtuar agjencive deri tek Kryeministri; të ketë një historik të pronës dhe regjistrimi i pyjeve dhe kullotave; gjithashtu të ketë një regjistër elektronik kadastral.



# Drejtoria e Shërbimeve Publike në kohë rekord përgatiti të gjitha dosjet për familjet e përmbytura



Gjatë vitit 2017 Drejtoria e Shërbimeve Publike situatën më të vështirë dhe impenjimin maksimal e ka pasur në periudhën e përmbytjeve të datës 30 nëntor. E gjithë drejtoria është gjendur pranë komunitetit për t'i ardhur në ndihmë në këtë rast fatkeqësie të përmbytjeve në të gjithë zonën e Bashkisë Kamëz, duke përballuar situatën emergjente.

Është bërë një reagim i menjëhershëm për përballimin e situatës emergjente. Menjëherë pas verifikimeve në terren nga grupet e punës për dëmet e konstatuara, ka filluar puna për vlerësimin e dëmeve financiare. Është bërë gjithçka që brenda kuadrit ligjor në fuqi të plotësohen të gjitha dosjet sipas procesverbaleve të konstatimit të sjella nga grupet e punës. Është hartuar projektvendimi për 697 familjet e përmbytura të datës 30 nëntor 2017 në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz. Kamza ishte Bashkia e parë në Republikë, e cila ka bërë monitorimin në terren, vlerësimin financiar nga komisioni i vlerësimit sipas urdhrat të kryetarit, miratimin e vendimit në Këshillin Bashkiak, marrjen e konfirmimit ligjor nga Prefektura dhe dërgimin për financim në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, së bashku me dokumentacionin përkatës.

Drejtoria e Shërbimeve Publike, si të gjitha strukturat e tjera të Bashkisë Kamëz, është angazhuar për të ofruar shërbime sa më cilësore ndaj komunitetit të Kamzës, duke u



bazuar në zbatimin e legjislacionit dhe akteve nënligjore që përditësojnë aktivitetin e saj. Gjatë vitit 2017 në programin e punës së kësaj drejtorie janë përfshirë shumë operacione dhe shërbime që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e imazhit të institucionit dhe ofrimit të zgjidhjeve reale për qytetarët.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar inspektimit të dëmtimeve të rrjetit të infrastrukturës rrugore nga punimet që janë kryer nga operatorë të ndryshëm, për rikthimin në gjendjen e mëparshme, në të gjitha zonat ku janë kryer këto ndërhyrje. Kjo strukturë ka qenë e motivuar jo vetëm në elementet e drejtpërdrejta të shërbimit ndaj qytetarëve, por



edhe ato të shërbimeve të tjera. Ndjeshmëria e këtij shërbimi ka gjetur një vlerësim pozitiv edhe në komunitet, duke bërë edhe më të angazhuar këtë drejtori për të vlerësuar çdo situatë që ka të bëjë me shërbimin ndaj tyre në të gjithë rrjetin e shërbimeve që mbulon kjo drejtori. Janë marrë në shqyrtim të gjitha kërkesat dhe ankesat nga qytetarë të Bashkisë me problematika të ndryshme, ku pjesës më të madhe të tyre i janë dhënë zgjidhjet përkatëse. Kontaktet me qytetarët për dëgjimin dhe zgjidhjen e problemeve të tyre kanë qenë të përditshme, pa kufizim orarësh dhe me një etikë të lartë të komunikimit.

## Analiza e Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike: Në 2017-ën vijoi diskriminimi i qeverisë ndaj Kamzës



Drejtoria e Ndhmës Ekonomike ka zhvilluar analizën e punës së saj për vitin 2017. Në materialin e paraqitur, theksohej se edhe në vitin që shkoi, qeveria vijoi diskriminimin e familjeve në nevojë të Kamzës, duke mos futur në skemën e ndihmës ekonomike qindra familje. Argumentimi kryesor vijon të jetë i njëjtë: mosplotësim i pikëve, ndërkohë që familjet që kanë aplikuar janë në një gjendje të mjerueshme. Kjo mbetet një nga problematikat më të mëdha që janë hasur gjatë vitit 2017, përjashtimi nga skema e ndihmës ekonomike e familjeve që vërtet kanë nevojë. Ndërkaq, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike ka qenë e angazhuar për të ndihmuar familjet në kushte të vështira social-ekonomike, por ka qenë e pamundur që kjo ndihmë të adresohet të këto familje tejet në nevojë. Punonjësit e kësaj drejtorie kanë qenë korrektë në komunikimin me qytetarët, duke bërë sqarimet e nevojshme për çdo problematikë që kanë ngritur ata.

Gjatë vitit 2017 numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike çdo muaj ka qenë mesatarisht 2376 dhe kanë përfituar çdo muaj mesatarisht 2153 familje, që i bie mesatarisht 223 familje refuzohen nga sistemi elektronik i SHSSH. Ky zvogëlim i numrit të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike ka ardhur si rezultat i heqjes së kompetencës së vendimmarrjes Këshillit Bashkiak Kamëz për miratimin e ndihmës ekonomike dhe kalimin si kompetencë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Ndërkohë, niveli i varfërisë në Bashkinë Kamëz jo vetëm që nuk është zbutur, por treguesit social-ekonomikë rezultojnë rritje të varfërisë.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2017 Bashkia ka trajtuar me ndihmë emergjente nga fondet e veta 497 familje në kushte shumë të vështira social-ekonomike apo familje që kanë pasur raste të ndryshme fatkeqësish.

## Qeveria u ka refuzuar ndihmën ekonomike qindra familjeve të varfra në Paskuqan



Gjatë analizës së punës njëvjeçare të Njesisë Administrative të Paskuqanit, u theksua se për shkak të qeverisë, vihet re rritja e numrit të familjeve të varfra. Megjithatë ka shtim të varfërisë, nga ana e kësaj qeverie u është refuzuar kërkesa qindra familjeve që kanë aplikuar për t'u trajtuar me ndihmë ekonomike. Kryesisht janë refuzuar me motivacionin se nuk marrin pikët e mjaftueshme, edhe pse këto familje jetojnë në gjendje të mjerueshme.

Ndërkaq, në analizën e prezantuar nga administratori i Njesisë, z. Faik Sula, u vu në dukje se në rastet e emergjencave është ngritur Komisioni i Emergjencave Civile, i cili bën të mundur hartimin e një plani për situatën e krijuar. Të tilla emergjenca ishin reshjet që filluan më datë 30 nëntor 2017 e në vazhdim, të cilat shkaktuan dëme materiale në disa familje. Me urdhër të kryetarit të Bashkisë u ngritën grupet e punës, të cilat bënë verifikimet në të gjitha familjet e përmbytura, duke mbajtur procesverbalet e konstatimit të dëmeve të shkaktuara në çdo familje dhe më pas duke ia dërguar Këshillit Bashkiak për miratim. Duhet theksuar që në Njesisë Administrative Paskuqan gjatë vitit 2017 ka pasur shumë herë më pak dëme nga përmbytjet krahasuar me vitin 2016. Kjo ka ardhur si rezultat i investimeve që Bashkia ka kryer dhe po kryen në Njesisë Administrative Paskuqan. Për këtë administratori i Njesisë ka falënderuar Bashkinë dhe kryebashkiakun Mziu për orientimin e investimeve në këtë zonë. Ai theksoi gjithashtu se edhe pse ka një rritje të luftës kundër informalitetit, mbetet përsëri sfida mbledhja e taksave dhe tarifave vendore.

Pasi falënderoi punonjësit e Njesisë Administrative të Paskuqanit për punën e bërë në vitin 2017, sekretari i përgjithshëm i Bashkisë, z. Qemal Çejku, është shprehur se mbeten ende sfida përpara gjatë 2018-ës, siç mund të jenë mbledhja e detyrimeve, të cilat janë burimi i vetëm i të ardhurave të Bashkisë. Kjo, me qëllimin që të kthehen në investime, ashtu siç e përmendi gjatë analizës administratori i Njesisë, z. Sula. Ka pesë vjet që qeveria nuk jep asnjë qindarkë për financimin e projekteve. Për këtë nevojitet edhe një ndërgjegjësim i qytetarëve të Paskuqanit për shlyerjen e këtyre detyrimeve.

## Drejtoria e Burimeve Njerëzore, rol kryesor në institucionin e Bashkisë për të siguruar një shërbim cilësor për qytetarët

Gjatë analizës së punës njëvjeçare të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Bashkinë Kamëz, u theksua se ajo ka rol kryesor në koordinimin e aktiviteteve për të siguruar që sistemi është në përputhje me politikat e administratës dhe të Këshillit Bashkiak, duke gjetur një zbatim të mirë në të gjithë institucionin e Bashkisë, duke siguruar kështu një shërbim cilësor për qytetarët.

Përgjegjësia kryesore e funksionit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është të rekrutojë, të përzgjedhë dhe trajtojë personelin për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e njesisë së qeverisjes vendore. Një nga pikat kyçe të menaxhimit efektiv të burimeve njerëzore ka qenë që punonjësit të dinë mirë se çfarë pritet prej tyre dhe po kështu drejtuesit të dinë mirë se çfarë pune duhet të mbulojë secili prej tyre. Harmonizimi i këtyre komponentëve ka siguruar që vendimet për personelin kanë qenë objektive dhe që punonjësit kanë pasur një trajtim të barabartë dhe të ndershëm. Gjatë vitit 2017 nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është bërë një punë cilësore për sa i përket praktikës së administrimit të shkresave, duke zbatuar me përpikmëri ligjet dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me protokollin dhe arkivin, rregulloren e kartotekës së personelit që kanë të bëjnë me ruajtjen, administrimin e dokumenteve që nga momenti i hyrjes së dokumentit në protokoll, duke i indeksuar, shpërndarë drejtorive përkatëse, kthimin e përgjigjeve brenda afateve, ruajtjen fizike dhe elektronike, përpunimin, shfrytëzimin në bazë të ligjeve në fuqi deri në momentin që këto dokumente në varësi të rëndësisë që kanë, të dorëzohen në Arkivin Qendror Vendor.

Për vitin 2017, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka realizuar menaxhimin e burimeve njerëzore, organizimin e strukturave, me synim përmirësimin e vazhdueshëm organizativ dhe funksional të Bashkisë.

Krahasuar me vitet paraardhëse, numri i punonjësve të administratës me arsim të lartë ka ardhur gjithnjë në rritje dhe numri i punonjësve me arsim të mesëm në minimizim në përputhje me zbatueshmërinë ligjore. Rreth 95% e nëpunësve administratës janë me arsim të lartë, të kualifikuar dhe të pajisur me diploma e certifikata të ndryshme që vërtetojnë specializimet e tyre. Në bashkëpunim me institucione të tjera janë kryer trajnime ku nëpunësit u janë nënshtruar provimeve që kanë bërë të mundur rritjen e aftësive profesionale dhe përmirësimin e njohurive të administratës, si rrjedhojë e së cilës ka ardhur një rritje e aftësive menaxhuese dhe funksionale e nëpunësve të Bashkisë.



## I sigurt drejt së ardhmes - Intervistë me presidentin e kompanisë "Pirraçi-U6"

**Urim Pirraçi: Në Kamëz e kam projektuar aktivitetin qysh në fillimet e punës sime, sepse taksat ishin më të ulëta, përpos edhe forcës punëtore që është pika kyçe e suksesit**

Ky është projekti i një njeriu që në projektion të jetës së vet pati nisjen dhe rritjen graduale të biznesit të tij. Ky është Urim Pirraçi, i cili qysh në moshë të re si gjysma e shqiptarëve emigroi për në Greqi. Shumë shpejt ai përqafoi idenë e të bërit biznes. Prej 20 vitesh që në fillimet e para arriti të konceptonte tregun në një vend të huaj, ku pa dyshim konkurrenca përbente sfidën kryesore për të shtrirë dhe forcuar më tej elementet e tregut.

Aftësia për të kuptuar dhe thithur situatën e bënë Urimin që të bashkëpunonte me biznesmenë grekë dhe të përfitonte nga përvoja, e cila dita-ditës do të rriste kapacitetet e tij individuale dhe shumë shpejt ai do të krijonte kompaninë e tij, e cila do të quhej "Pirraçi-U6, Konstruksiione metalike".

Por çfarë është "Pirraçi-U6"? I vetmi pronar i kësaj kompanie, e cila në vitin 2006 transferon veprimtarinë në Shqipëri dhe kryesisht i stacionuar në Kamëz. Kur e pyesim pse në Kamëz ai pa ndrojtje përgjigjet për shkak të politikave lehtësuese fiskale si dhe krahut të lirë të punës dhe moshës së re që përmban kjo zonë. Ai i vetëm arriti që brenda një kohe shumë të shkurtër të krijonte një administratë mjaft profesionale, që do të ishte linja e parë, e cila nën drejtimin e tij do të rriste kapacitetet prodhuese dhe menaxhuese. "Një staf mjaft i kualifikuar është një biznes dhe treg i garantuar", - thotë në fjalët e tij Urimi.

Kompania ka një profil të qartë dhe të besuar, pasi kjo kompani "Pirraçi-U6" operon në treg i sigurt, në sektorin e konstruksiioneve metalike prej shumë vitesh në Greqi, Shqipëri dhe nga viti 2011 ka hapur një filial të ri në Kosovë. Portofoli shumë cilësor i klientëve me të cilët "Pirraçi-U6" bashkëpunon janë treguesit më të mirë të shërbimeve dhe produkteve që ofron kjo kompani.


"Siguri dhe garanci" dhe "I sigurt drejt së ardhmes" nuk janë thjesht sloganet e "Pirraçi-U6", por është filozofia e kësaj kompanie.

Kompania përmban një sistem cilësor kontrolli në prodhim dhe zhvillim. Siguria e kompanisë ka një staf mjaft të kualifikuar me një kompozim profesional. Punimi i hekurit bëhet me makineri teknologjisë evropiane, në të cilat çdo detaj mendohet me rëndësi. Cilësia e hekurit është e certifikuar me kriteret më të larta evropiane. Ngritja e ndërtesës dallohet nga cilësia dhe shpejtësia sipas kërkesave të klientëve.

Kompania ka marrë përsipër çdo lloj ndërtese që ka për bazë konstruksiione metalike. I sigurt është suksesi, sepse e tillë është ndërtuar strategjia menaxhuese e këtij biznesi, i cili çdo ditë e më tepër po zgjerohet dhe do të krijojë pa dyshim edhe vende të lira pune kudo në rajon për të arritur atë çfarë është projektuar që në fillim ky biznes. Më poshtë intervista e plotë me z. Urim Pirraçi.

**Përshëndetje! Jemi në një nga bizneset më të suksesshme në territorin e Bashkisë Kamëz dhe po e nis me këtë pyetje: Çfarë përbën për ju ky biznes?**

Për mua ky biznes është gjithçka dhe qëllimi im ka qenë ta ndërtoj në territorin e Bashkisë Kamzës.



**Si ju lindi ideja për të investuar në Kamëz?**

Duke parë fuqinë punëtore, duke parë vendin ku ndodhet në Bashkinë Kamëz, ishte shumë e rëndësishme të investohej në këtë vend, sepse nuk kishte një biznes të tillë për këtë që bëjmë ne. Për këtë arsye e ndërtova biznesin në Kamëz.

të bashkëpunuar me institucionet vendore, por dhe ato që do të investojnë për të rritur me ritme të shpejta brezat profesionalë në ndihmë të nevojave të biznesit.

**Ju jeni ortaku i vetëm i kompanisë që ushtron aktivitetin?**

Po, është e vërtetë. Unë jam ortaku i vetëm i

integrohet në Evropë përpara vendeve të Ballkanit Perëndimor, që aspirojnë për t'iu bashkëngjitur familjes evropiane?

Është produkti i tillë që kërkohet shumë në Evropë.

**Ju keni një rritje standarde dhe një qëndrueshmëri të këtij biznesi, pavarësisht nga lufta e ashpër e politikave ekonomike, ndërsa ju vazhdoni të hapni vende të reja pune, duke punësuar me qindra të rinj, pse jo, brenda Shqipërisë dhe jashtë saj.**

Besoj që për një biznesmen nuk kanë rëndësi politikët. Ka rëndësi tregun, sepse biznesi nuk duhet të ketë lidhje me politikën. Në momentin që je i pastër në shtet, në tatime dhe taksa, nuk besoj se krijon ndonjë problem.

**E mendoni që partneriteti është një forcë që do ta shtyjë më tej biznesin tuaj apo e shikoni veten të veçuar për të arritur suksese?**

Mendoj se më mirë është pa partneritet, për arsye se politikët lëvizin dhe besoj se është më i qëndrueshëm biznesi vetëm.

**Keni menduar që në një të ardhme të afërt apo të largët cili do të jetë projekti juaj për të rritur kapacitetet e investimeve?**



**Kur e keni filluar për herë të parë këtë biznes dhe ku?**

Biznesi ka ardhur nga Greqia. Kam punuar 20 vjet atje. Ndërsa në Shqipëri jam prej vitit 2006 që kam filluar të transferoj të njëjtin aktivitet dhe jam shumë i lumtur e njëkohësisht dhe i surprizuar me arritjet që kam pasur.

**Në Shqipëri ku keni ndërtuar për herë të parë?**

Për herë të parë në Shqipëri kemi ndërtuar ish-Praktikerin në Institut, më pas e kemi vazhduar në gjithë Shqipërinë.

**Mund të na flisni pak çfarë lehtësirash kishit këtu në Kamëz?**

Në Kamëz e kam projektuar aktivitetin qysh në fillimet e punës sime, për arsye madhore, që merr kuptimin e një politike mbarëkombëtare, sepse taksat ishin më të ulëta, përpos edhe forcës punëtore që është pika kyçe e suksesit të kompanisë sime. Këto janë dy pika të rëndësishme që më bënë të investoja këtu në Kamëz. Mbetem i hapur për

kompanisë "Pirraçi-U6", tani për tani deri në një pikë të dytë, me një firmë tjetër që edhe ajo të jetë shumë e suksesshme.

**Pse "Pirraçi-U6"?**

"Pirraçi-U6", për shkak të gjenealogjisë sime familjare dhe për të ruajtur një vazhdimësi të biznesit tim sipas kësaj praktike që unë kam ndërtuar.

**Pse U6?**

Është emri dhe viti që është hapur kompania në Shqipëri.

**Ju tashmë jeni zgjeruar përtej territorit të Shqipërisë edhe në vendet fqinje, edhe në vendet ku impakti i këtij biznesi është i ndjeshëm. Ku mendoni që do ta shtrini më tej: në Kosovë, Maqedoni apo diku tjetër?**

Jemi të gatshëm për në Rumani dhe me hapjen e biznesit të ri do të jemi në shumë vende evropiane, sepse është produkti i tillë, që duhet shitur nëpër vende të tilla.

**Pra, në njëfarë mënyre "Pirraçi"**

Ne jemi në investime tani për tani, ndërsa kam një fabrikë në Vorë për prodhimin e panelit, sanduiçit dhe pas saj do të vazhdojmë më tej, sepse biznesi nuk ndalet. Me këtë ritëm që po ecën aktiviteti im, mendoj se shumë shpejt do të shndërrohem në një korporatë të vërtetë evropiane.

**Çfarë trashëgimie keni marrë nga familja dhe prindërit?**

Kam marrë trashëgiminë e një kulturë, të një respekti nga babai dhe për atë është ndërtuar gjithçka, kjo kompani që kam.

**Ju harxhoni 24 orë në krye të punës, pra ju jeni njeri i punës. Në këtë kontekst, si e shikoni ju partneritetin me administratën tuaj dhe a mendoni ju që është një pikë e fortë kjo?**

Administrata është pika "më e dobët", pika kyçe. Pika më e vështirë që ka biznesi dhe pa administratën nuk ecim dot. Është vështirë në Shqipëri për të pasur një administratë profesionale, por është kryesorja për biznesin sot.